



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/199 Nr. i faq./Br.str./No.pg 2

Data/Datum/Date 27/08/2020

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 40, 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.08.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1048/20 i datës 10.08.2020 dhe merret vendimi paraprak për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, gjendet në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Bugarska Cesma, sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-07998-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2577m², me kulturë Kullosë e Klasës 4, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen dhe të rritet vlera e asaj prone.
4. Afati kohor për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej dhjetë vite (10) vite.
5. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i tyre mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepen personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të

Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01. Nr.576 datë 28.02.2017 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

8. Obligohen Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. 99/20
Me datë: 27.08.2020

